



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS
SENATI AKADEMIK

Nr. 1428/16 Prot.

Tiranë, më 14.10.2021

VENDIM

Nr. 119, datë 14.10.2021

PËR

**NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 11 DATË 10.02.2020 TË SENATIT AKADEMIK
“PËR MIRATIMIN E KRITEREVE TË PRANIMIT TË STUDENTËVE PËR VITIN
AKADEMIK 2021-2022 PËR FSHL, FVFR DHE FSHR”**

DHE

**SHTYRJEN E AFATIT PËR PLOTËSIMIN E KRITERIT TË PRANIMIT GJUHË E
HUAJ NË PROGRAMIN E STUDIMIT TË CIKLIT TË DYTË “MASTER I
SHKENCAVE”**

Në zbatim të pikës 3 dhe 4, të nenit 76 (Pranimi në Ciklin e Dytë të Studimeve), të Ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në IAL e RSH”, në shkresën e MASR me nr. 3228 të datës 27.03.2018 “Dërgim informacioni mbi marrëveshjet e gjuhëve të huaja”; bazuar në kërkesat e Fakultetit të Veprimtarisë Fizike dhe Rekreacionit dhe Fakultetit të Shkencave të Lëvizjes (bashkëngjitur); në situatën e krijuar të pandemisë globale COVID-19, si dhe problematikave që ka sjellë mosvaksinimi i një pjese të madhe të studentëve në paisjen e tyre me diplomë/çertifikatë të gjuhës së huaj; për të mos penalizuar rregjistrimin në vitin akademik 2021-2022, Senati Akademik i UST-së

VENDOSI:

1. Të shfuqizojë pikën 1.C.(4) të Vendimit nr.11 datë 10.02.2020 “Për miratimin e kritereve të pranimit të studentëve për vitin akademik 2021-2022 për FSHL, FVFR dhe FSHR”, “Për ciklin e dytë të studimeve “Master Shkencor”, në të cilën citohet: ...kandidatët duhet të kenë notë mesatare mbi 7. (Vendimi bashkëngjitur)
2. Amendimin e pikës 1.C.(4) të Vendimit nr.11 të datës 10.02.2020 të Senatit Akademik “Për miratimin e kritereve të pranimit të studentëve për vitin akademik 2021-2022 për FSHL, FVFR dhe FSHR”, ku kriteri pranimit nga i përcaktuar 7 (shtatë), të ndryshohet në “kriteri i pranimit të jetë ai i mesatares më të lartë”.

3. Studentët që rregjistrohen në ciklin e dytë të studimeve “Master i Shkencave” për vitin akademik 2021-2022, duhet të kenë të fituar një diplomë në një nga gjuhët e përcaktuara, brenda vitit të parë të studimeve master dhe ta dorëzojnë atë në Sektorin e Sekretarisë Mësimore Digjitale, shoqëruar me një deklaratë të firmosur nga student për plotësimin e këtij kriteri para sezonit të provimeve (formulari i deklaratës bashkëngjitur).
4. Ky vendim i përcillet për zbatim Administratorit, Njësive Kryesore, Sektorit të Sekretarisë Mësimore Dixhitale.
5. Vendimi hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I SENATIT AKADEMIK

Prof.Dr.Agron KASA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS
FAKULTETI I SHKENCAVE TË LËVIZJES
DEKANATI

Nr. 1439/ Prot.
11

Tiranë, më 12.10 2021

Lënda: Propozim mbi pranimin e studentëve të ciklit të dytë të studimeve “Master i Shkencave”, për vitin akademik 2021-2022

REKTORIT TË UNIVERSITETIT TË SPORTEVE TË TIRANËS
PROF.DR. AGRON KASA

I nderuar Z. Rektor!

Në vijim të procesit të regjistrimit për studentët që do regjistrohen në ciklin e dytë të studimeve “Master i Shkencave” për vitin akademik 2021-2022, si dhe në mbështetje të nenit 76, pika 4 e Ligjit 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në IAL në Republikën e Shqipërisë”, Dekanati i FSHL propozon :

- Shtyrjen e afatit të dotëzimit të Certifikatës së mbrojtjes së gjuhës së huaj deri në përfundim të studimeve në programin e ciklit të dytë të studimeve “Master i Shkencave” në “Shkenca Sportive” para mbrojtjes së punimit të diplomës.
- Kriteri i klasifikimit të kandidatëve të jetë ai i notës mesatare më të lartë.

Duke ju falenderuar paraprakisht.

Prof.Dr. **Dhimitraq PRIFTI**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS
FAKULTETI I VEPRIMTARISË FIZIKE DHE REKREACIONIT
DEKANATI

Nr. 1439 Prot.

Tiranë, më 12.10.2021

Lënda: Propozim mbi pranimin e studentëve në ciklin e dytë të studimeve “Master Shkencor” pranë FVFR, për vitin akademik 2021-2022

REKTORIT TË UNIVERSITETIT TË SPORTEVE TË TIRANËS
PROF. DR. AGRON KASA

I Nderuar Z. Rektor!

Mbështetur në Ligjin 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në IAL në Republikën e Shqipërisë”, neni 76, pika 4 si dhe në vijim të procesit të pranimit të studentëve në ciklin e dytë të studimeve “Master Shkencor – Aktiviteti Fizik dhe Shëndeti” pranë Fakultetit të Veprimtarisë Fizike dhe Rekreacionit, për vitin akademik 2021-2022, Dekanati i FVFR ju propozon:

- 1- Shtyrjen e afatit të dorëzimit të Certifikatës së mbrojtjes së gjuhës së huaj deri në përfundim të studimeve në programin e ciklit të dytë “Master Shkencor – Aktiviteti Fizik dhe Shëndeti”, para mbrojtjes së punimit të diplomës.
- 2- Kriteri bazë i klasifikimit të kandidatëve të jetë ai i notës mesatare më të lartë.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin!

DEKANATI

Prof. Asc. Dr. Ferdinand MARA
